



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 11 të Ligjit për Vullat në Institucionet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-054, të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2009-MSHP për Formën e Vullës Katrore si dhe Llojin, Nuancat dhe Parametrat Teknikë të Ngjyrës së Vullës Katrore si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formim të Komisionit

- Formohet dhe emërohet Komisioni për zhvillimin e procedurave e marrjes së lejes për porositjen e vullës për nevojat e Drejtorisë së Pronës dhe Çështjeve Ligjore në Komunën e Prizrenit dhe të Drejtorisë së Tatimit në Pronë në Komunën e Prizrenit. Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:
 - 1.1. Fatmir Badalli,..... kryesues,
 - 1.2. Kastriot Hoxhaj,anëtar,
 - 1.3. Erzen Musliu,.....anëtar.
- Detyrat e Komisioni nga pika 1 të këtij Vendimi janë paraparë në dispozitat e Ligjit për Vullat në Institucionet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-054 Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2009-MSHP për Formën e Vullës Katrore si dhe Llojin, Nuancat dhe Parametrat Teknikë të Ngjyrës së Vullës Katrore dhe akte tjera të ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- Obligohet Drejtorja e Administratës, kryesuesi i Komisionit dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.